



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:234106

Datë: 19.10.2023

Numri i dokumentit: 04806688

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.144/22

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me bashkëpunëtoren profesionale Qendresa Sadrijaj, në çështjen penale kundër të pandehurit E. M. , për shkak të veprës penale “Lëndim i lehtë trupor” , nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm nën shenjën PP/II.nr. 1782/21 te datës 18.02.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 16.10.2023, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Dorian Juniku, të akuzuarit E. M. dhe mbrojtësit av. Burhan Shabanaj sipas detyrës zyrtare, të njëjtën ditë mori dhe shpalli ndërsa me datë 18.10.2023, përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Ndaj të pandehurit:

E. M. , i lindur me ....., në fsh. L., Komuna Pejë, rr. T.Sh., pa nr. i biri i I. dhe V., e vajzërisë S., identifikohet në bazë të letërnjoftimit me numër personal ....., punëtor në “E. G.”, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme shtetas i R. së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me datë 29.09.2021, rreth orës 19:50 në fshatin L., K. Pejë, me mjet të rrezikshëm i cili mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor, personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm për shëndetin dhe atë të dëmtuarit K. N., në mënyrën që, pasi ky i fundit refuzon t’i kryej pagesën për ushqimin që i kishte dërguar i pandehuri si dërgues, me arsyetimin se është

vonuar dhe ftohur ushqimi, i pandehuri i lë ushqimin tek dera e oborrit të shtëpisë së të dëmtuarit, për t'u kthyer pas 20 minutave, ku i njëjti nga makina nxjerr një shkop druri dhe e godet të dëmtuarin në kokë dhe dorën e tij të djathtë duke i shkaktuar lëndim të lehtë trupor.

- me çka ka kryer veprën penale “Lëndimi i lehtë trupor” nga neni 185 par. 2 lidhur e par. 1, nën par. 1.4 të KPRK-së.

-

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074):

### GJYKON

Të pandehurit E. M. i shqipton:

- I. DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR, në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuar nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej dy (2) vitesh, e cila periudhë do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- II. Nëse e akuzuari gjatë periudhës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat shqiptohet dënimi me burgim prej dy (2) apo më tepër vjet, gjykata do t' a revokojë dënimin me kusht.
- III. I dëmtuari K. (Z.) N., me vendbanim në L.oxhë me adresë në Rr.”T. Sh.”, nr. ..., K-Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko- civil.
- IV. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

### ARSYETIM

- A. Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 18.02.2021 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1782/21 kundër të pandehurit E. M. , për shkak të veprës penale “Lëndim i lehtë trupor” , nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 16.10.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, i pandehuri E. M. , mbrojtësi i të pandehurit i caktuar sipas detyrës zyrtare av. Burhan Shabanaj, ndërsa nuk kishte prezantuar i dëmtuari K. N. për të cilin fletë kthesa është kthyer : “ pala i pa njohur në këtë adresë”.

Gjykata duke u bazuar në nenin 240 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, ku thuhet se: “ Gjatë shqyrtimit fillestar duhet të jenë të pranishëm prokurori i shtetit, i pandehuri apo të pandehurit dhe mbrojtësit. 2. Pala e dëmtuar ose viktimave dhe mbrojtësi i viktimave ose përfaqësuesi i viktimës njoftohen për seancën e shqyrtimit fillestar dhe ata kanë të drejtë të jenë të pranishëm, por mungesa e tyre nuk është pengesë për mbajtjen e seancës”, e nën këto kushte ligjore seanca është mbajtur dhe i pandehuri e ka pranuar fajësinë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të të pandehurit e në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovojë pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Ne lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurori i shtetit deklaroi: “Meqenëse i akuzuari e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe atë konform kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KPPRK-së, i cili e kuptoi natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bëri vullnetarisht dhe në mbështetje të fakteve të çështjes që përmban aktakuza, andaj nga Gjykata kërkoi që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënoj si pas ligjit si dhe ta obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rasatin përcaktimet të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese, ndërsa në kuptim të dispozitave ligjore të nënti 70 të KPPRK-së, si rrethanë rënduese të vlerësoj shkallen e lartë të dashjes e kjo për faktin se i pandehuri edhe pse kishte mundësi të të heq dorë nga kryerja e veprës penale në momentin e largimit ku kishte dërguar ushqimin, i njëjti duke dashur që të shkaktohet, kthehet pas 20 minutave në vendin ngjarjes, nga makina nxjerr një shkop druri me të cilin e godet në kokë dhe dorën e djathtë”.

Ne lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit mbrojtësi i të pandehurit deklaroi: “Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykatës i propozojmë që ti ketë parasysh këto rrethana lehtësuese: pranimin e fajësisë në fazë të hershme të procedurës penale, pendimin e thellë dhe shprehjen e keqardhjes, moshën e tij të re, faktin se asnjëherë më parë nuk ka ra ndesh me ligjin, gjendjen e dobët ekonomike, si dhe faktin se kam kuptuar se të njëjtit janë pajtuar në mes veti, andaj Gjykatës i propozoj që të ketë parasysh qëllimin primarë të dënimit e që është riedukimi e jo hakmarrja ndaj të njëjtit, andaj vlerësoj që në rastin konkret rrethanat lehtësuese i dominojnë në mënyrë të plotë ato rënduese që u thirr prokuroria, andaj përfundimisht i propozoj gjykatës të shqiptoj një sanksion penal sa më të lehtë për të njëjtin”.

Në lidhje me lartësinë dhe llojin e dënimit i pandehuri deklaroi: “Pajtohem me mbrojtësin tim më vjen shumë keq për këtë rast që ka ndodhë, është rasti i parë që më ka ndodhë, asnjëherë ma nuk kam pas probleme me të dhe jam pajtuar menjëherë pas këtij rasti, shpreh keqardhje dhe pendohem shumë për këtë vepër që e kam kryer”.

#### B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të çështjes.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin rrethanat rënduese që parashihen në nenin 70 par.2 pika 2.2 të KPRK-së, është dashja e lartë e të pandehurit në kryerjen e veprës penale përderisa si rrethanë lehtësuese mori rrethanën konform nenin 70 par.3 pika 3.10 të KPRK-së, pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, faktin se i njëjti është pajtuar me të dëmtuarin dhe tanimë nuk kanë probleme, andaj duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 42 e 49 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë që për këtë vepër penale të shqiptohet dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vite, e në këtë rast gjykata pas analizimit, shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha rrethanave ka vendosur që të akuzuarit t’ i shqiptojë dënim me burg të kushtëzuar prej një (1) viti nëse brenda periudhës

kohore të verifikimit prej dy (2) vitesh nuk kryen veprë tjetër penale. Përkitazi me këtë dënim të shqiptuar gjykata u bazua në nenin 49 par.1 në lidhje me kushtet për shqiptimin e dënimit me kusht, ku parashihet që dënimi me kushte shqiptohet për vepra penale të dënueshme deri në pesë (5) vite burgim, e duke pasur parasysh se vepra penale që i vihet në barrë të akuzuarit dënohet me burgim deri në 5 vite, përderisa kushti apo periudha e verifikimit prej dy (2) vitesh i është llogaritur ashtu siç parashihet me nenin 48 par.2 të KPRK-së, ku thuhet se: "... koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit e as më e gjatë se pesë (5) vite".

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit E. M. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko civil u mor konform nenit 462 par.2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal

P.nr.144/22, me datë 18.10.2023

Bashkëpunëtorja profesionale:

Qendresa Sadrijaj

Gjyqtari i vetëm gjykses:

Leon Përlaska

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.